



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 21.1.1-2013-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013**

**Prishtinë, Qershor, 2014**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Zyrës së Kryeministrit në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm (ose Zëvendës Auditorin e Përgjithshëm), Ibrahim Gylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti, i mbështetur nga, Arvita Zyferi (Udhëheqës Ekipi), dhe anëtarët e ekipit Arian Haxha dhe Muhamet Balaj.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	7
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak .....	11
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli .....	12
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	30
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	33

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Zyrës së Kryeministrit për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Kryeministrin dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Në kuadër të këtij auditimi janë përfshirë edhe agjensionet vartëse si: Agjensioni i Ushqimit dhe Veterinarisë, Agjensioni i Statistikave të Kosovës, Agjensioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës dhe Agjensioni për Barazi Gjinore .

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 10/11/2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pasqyrat Vjetore Financiare – pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Zyrës së Kryeministrit (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Zyrës së Kryeministrit .

### Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

#### **Theksim i Çështjes**

Dëshirojmë ta tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpenzimet për subvencione nuk mbështen nga dëshmi të mjaftueshme për ta arsyetuar vlefshmërinë e tyre. **(ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).**

## **Konkluzioni i përgjithshëm**

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Sistemi i kontroleve të brendshme në Zyrën e Kryeministrit është i dizajnuar në mënyrë të duhur mirëpo nuk është zbatuar plotësisht në të gjitha fushat e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në veçanti, mungesa e zbatimit të planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve tona të vitit të kaluar ka rezultuar me mangësi të njëjta edhe në vitin 2013. Rekomandimi i dhënë nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm lidhur me klasifikimin e drejt të buxhetit/shpenzimeve për investime kapitale përkundër përpjekjeve të Zyrës së Kryeministrit përkatësisht Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë me Ministrin e Financave ende nuk është adresuar.

Procesi i konsolidimit të Pasqyrave Vjetore Financiare mes Zyrës së Kryeministrit dhe Agjencive Ekzekutive nuk ishte adekuat. Aranzhimet ekzistuese të llogaridhënies, raportimit dhe kërkesave mes Agjencive Ekzekutive dhe Zyrës së Kryeministrit nuk janë të përshtashme.

Praktika aktuale e menaxhimit të subvencioneve nuk ofron siguri të mjaftueshme nëse ato shfrytëzohen për qëllimet e dedikuara. Raportimi nga ana e përfituesve nuk ishte i rregullt. Kjo ka shkaktuar mungesën e informatave rreth efektit të tyre të nevojshëm për mbikëqyrje dhe vendimmarrje.

Po ashtu, menaxhimi i prokurimit, i pasurisë së agjencioneve ekzekutive si dhe mbyllja e avanseve me kohë ka vend për përmirësim.

Me qëllim të ruajtjes së kredibilitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, Zyra e Kryeministrit duhet të ndër marr veprime konkrete për avancim të mëtutjeshëm. Për këtë qëllim në vijim kemi përmbledhur rekomandimet tona kryesore.

### **Rekomandimet kryesore të Auditorit të Përgjithshëm për Kryeministrin e Kosovës janë si në vijim:**

Përmes Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit dhe Kryeshefave Ekzekutiv të Agjencive të siguroj që :

- Pagesat e subvencioneve bëhen vetëm në kuadër të kornizës ligjore. Ku raporte të hollësishme në afate kohore të caktuara sigurohen për të konfirmuar arritjen e objektivave dhe vlefshmërinë e shpenzimeve dhe të mbështetur nga një nivel i përshtatshëm i dëshmive posaqërisht të subvencioneve të dhëna me vendim të Kryeministrit. Ndarja e subvencionit në këste dhe kushtëzimi i çdo kësti me raportim mbi shpenzimin e fondeve të këstit paraprak mund të jetë alternativa më e duhur e cila do të stimulojë një përgjegjësi të madhe të përfituesve;
- Plani i rishikuar i veprimit duhet të përcaktoj një afat kohor praktik por sfidues për adresimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm me identifikimin e anëtarëve të përgjegjshëm dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësishme më të madhe. Zbatimi i planit duhet të rishikohet nga Zyra e Kryeministrit në baza tremujore;

- Shtimin e marrëveshjeve të llogaridhënies mes Zyrës së Kryeministrit dhe agjencive të saj të cilat sigurojnë struktura efikase të raportimit për të mbështetur menaxhimin financiar në kohë dhe të fuqishëm nga Zyra e Kryeministrit mbi të gjitha fushat e përgjegjësisë dhe të mbështesë një proces efektiv të konsolidimit të Pasqyrave Vjetore Financiare;
- Është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë. Kjo duhet të përfshijë raporte që i ofrojnë një nivel të përshtatshëm të të dhënave financiare dhe operationale që mbulojnë të gjitha përgjegjësitë e Zyrës së Kryeministrit . Takimet e ekipit të menaxhmentit duhet të regjistrohen për të demonstruar shqyrtim kritik;
- Përgatitja e buxhetit paraprihet nga një proces rigoroz i vlerësimit që pasqyron të gjitha informatat relevante përfshirë realizimin në vitet e mëparshme / dhe ndryshimet e pritura të vitit. Performanca buxhetore duhet të monitorohet në baza mujore dhe pengesat për nivelet e planifikuara të ekzekutimit të buxhetit të identifikohen dhe adresohen me kohë;
- Është shtuar komunikimi me Ministrin e Financave për të siguruar që hartimi i buxhetit dhe klasifikimi i shpenzimeve për investime kapitale dhe mallra dhe shërbime bëhet sipas planit kontabël të thesarit për të mundësuar regjistrimin dhe raportimin e duhur të shpenzimeve ;
- Është analizuar “tregu aktual i kafshëve” në Kosovë për të përcaktuar arsyet potenciale për mungesë të ofertuesve për shitje të mishit dhe të përdor këtë informacion për të kërkuar më shumë interes në ankand. Rregullat formale apo një udhëzim administrativ duhet të hartohet për të siguruar procedura në kohë dhe efikase për shitjen me ankand të mishit të konfiskuar;
- Janë analizuar mangësit sistematike në fushën e prokurimit dhe të identifikoj në mënyrë të qartë barrierat për zbatimin efektiv të kontroleve ekzistuese. Kontrollat e shtuara për shqyrtim mbikëqyrës duhet të zbatohen për të siguruar që gabime të ngjashme janë shmangur në të ardhmen;
- Janë ndërmarr masat konkrete për sigurimin e dokumentacionit përkatës për posedim të tokës dhe ndërtesës , krijimin e komisioneve vlerësuese për vlerësimin e pasurisë, regjistrimin e tyre si dhe raportimin në Pasqyrat Vjetore Financiare e vitit 2014;
- Janë marr masat e duhura për të siguruar se kryejnë me kohë të gjitha obligimeve, dhe nuk hyn në obligime pa zotimin e mjeteve; dhe
- Kryeministri të siguroj staf të mjaftueshëm për të siguruar një Njësi të Auditimit të Brendshëm më efektiv dhe të siguroj se aktiviteti i auditimit të brendshëm në të ardhmen bazohet në rrezik duke ofruar mbulueshmëri dhe i jep prioritet fushave me rrezikshmëri të lart çdo vit.

### **Përgjigje nga Menaxhmenti – auditimi i vitit 2013**

Menaxhmenti është pajtuar me të gjeturat tona të auditimit dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet tona.

---

## 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Zyrës së Kryeministrit (ZKM) të përgatis Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të hollësishëm, të cilat janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë. ZAP ka kryer auditimin menaxherial të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) i cili do të raportohet në një raport të veçantë të auditimit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

## 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Në përgjithësi cilësia e informatave në PVF për vitin 2013 ishte e mirë. Gabimet materiale në dy pasqyrat kryesore të periudhës nëntë mujore dhe në draft pasqyra janë marrë parasysh nga menaxhmenti i ZKM-së dhe pas korigjimit PVF finale kanë rezultuar pa gabime

### 2.1 Opinioni i Auditimit

#### *Opinion i pamodifikuar<sup>1</sup> me Theksim të Çështjes*

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

#### **Theksim i Çështjes**

Dëshirojmë ta tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpenzimet për subvencione nuk mbështeten nga dëshmi të mjaftueshme për të arsyetuar vlefshmërinë e tyre.

**(ISSA 200 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes)**

<sup>1</sup> Termi „opinion i pamodifikuar” është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar” i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (ISSAI 200). Për më shumë informacion referohu në shtojcën I.



## 2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

### Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, e datës 10/11/2013, është identifikuar një rrezik domethënës në PVF lidhur me klasifikimin e shpenzimeve. Gjatë kryerjes së auditimit, ne kemi identifikuar një tjetër rrezik në lidhje me mungesën e raportimit nga ana e përfituesve të subvencioneve. Këto janë rreziqe të anomalive materiale, nga të cilat mund të rezultojë një opinion i modifikuar, përfshirë Theksimin e Çështjes.

Rreziku i anomalive materiale që ne kemi identifikuar në lidhje me keq-klasifikimin e shpenzimeve ka ndodhur. Mirëpo, duke pasur parasysh se ZKM ka bërë përpjekje për adresimin e kësaj çështje te Ministria e Financave me rastin e planifikimit të buxhetit, dhe sipas kërkesës tonë ka shpalosur këtë në PVF 2013 kjo nuk do të ndikoj në opinionin e auditimit.

**Rreziku tjetër** i materializuar është paraqitur më poshtë.

### Rreziku i identifikuar

**Çështja 1 – Prioritet i lartë – Mungon dokumentimi i subvencioneve të dhëna të cilat do të mbështesin vlefshmërin e shpenzimeve.**

### Përgjigja dhe të gjeturat e auditimit

Ne i kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për të siguruar se mjetet e dhëna në forme të subvencioneve dhe transfereve janë të mbështetura me raportim të shpenzimit të tyre. Në memon e auditimit të ndërmjetëm ne kemi këshilluar menaxhmentin për nivelin e dëshmive të kërkuara për të konfirmuar se buxheti është shpenzuar për qëllimet e caktuara paraprakisht.

Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar sepse Menaxhmenti ka dështuar të aplikojë përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm. Në subvencionet e dhëna me anë të vendimeve të Kryeministrit në vlerë prej 140,620€ mungonë argumentimi i shpenzimeve dhe raporteve të cilat do të mbështetnin vlefshmërin e shpenzimit për subvencionet e dhëna

**Rekomandimi 1 – Prioritet i lartë-** Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së duhet të sigurojë që pagesat e subvencioneve janë bërë vetëm në kuadër të kornizës ligjore ku raporte të hollësishme janë siguruar në afate kohore të caktuara. Këto duhet të konfirmojn arritjen e objektivave dhe vlefshmërin e shpenzimeve dhe të mbështetur nga një nivel i përshtatshëm i dëshmive në veçanti të subvencioneve të dhëna përmes vendimeve të Kryeministrit. Ndarja e subvencionit në këste dhe kushtëzimi i çdo kësti me raportim mbi shpenzimin e fondeve të këstit paraprak mund të jetë alternativa më e duhur e cila do të stimuloj një përgjegjësi të madhe të përfituesve.

## 2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

### Përshkrimi

Pasqyrat vjetore financiare duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rr.F nr. 03/2013; dhe
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, e datës 18/12/2012, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti.

Në draft pasqyrat financiare ishin të nevojshme disa korrigjime dhe ne kemi dhënë disa sugjerime për të përmirësuar të dhënat financiare dhe shpalosjet përshkruese për të siguruar plotësinë e pasqyrave kryesore dhe shpalosjeve:

- Në pasqyrën e ekzekutimit, tek buxheti fillestar për mallra dhe shërbime ZKM ka paraqiturë vlerën prej 3,528,352€ ndërsa është dashur të paraqitet 2,528,352€;
- Në pasqyrën e ekzekutimit, tek buxheti final për paga dhe mëditje ka paraqitur 3,639,899€ ndërsa është dashur të paraqitet 3,603,271€; dhe
- Pas këshillës tonë, ZKM ka shpalosur çështjen e klasifikimit të shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve si investime kapitale.

Marrë parasysh këtë - Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtetë.

## 2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

### Përshkrim

Përveç hartimit të PVF-ve, nga ZKM kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raportet operative (të performancës),
- Draft plani i prokurimit me kohë; dhe
- Raportin mbi kontrollet e brendshme, përfshirë raportin e vetë-vlerësimit.

Ne nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto. Të gjitha raportet janë dorëzuar në MF dhe institucionet e tjera gje gjëse brenda afateve kohore. Përmbajtja dhe informatat e dhëna në këto raporte janë të plota.

### **Rekomandimi**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## **3 Rekomandimet e vitit paraprak**

### **Konkluzioni i përgjithshëm**

ZKM ka bërë progres të kufizuar në adresimin e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe disa çështje të rëndësishme duhet të adresohen më tutje për të siguruar përmirësimin e fushave kryesore të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

### **Përshkrimi**

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2012 të ZKM-së ka rezultuar me 14 rekomandime. ZKM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen të gjitha rekomandimet. Por vetëm tri rekomandime ishin adresuar plotësisht, dy pjesërisht, dhe nëntë rekomandime kanë mbetur të pa adresuara.

### **Rekomandimet**

---

#### **Çështja 2 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Vetëm një numër i vogël i rekomandimeve të vitit të kaluar ishin adresuar si pasoj mangësit të njëjta ishin prezente edhe në 2013. .

**Rreziku** Dështimi për të zbatuar rekomandimet AP në sistemet kyçe financiare mund të rezultojë në zbatimin e dobët të buxhetit, humbje financiare dhe vlera e dobët për para në fushat e prokurimit dhe të shpenzimeve të tjera, të dhënat jo të plota të aseteve dhe joefikasitet vazhdueshëm në aktivitetet operative të ZKM-së.

**Rekomandimi 2** Plani i rishikuar i veprimit përcakton një afat kohor praktik por sfidues për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP me identifikimin e anëtarëve të përgjegjshëm dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësishme më të madhe. Zbatimi i planit duhet të rishikohet nga ZKM në baza tremujore.

## 4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe të rezultateve nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky nivel, për shembull, mund të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrollet operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm dhe Komitetet e Auditimit.

Derisa kontrollet mbi të hyrat ishin efektive, kontrollet rreth disa kategori të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që ZKM të ketë vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të buxhetit. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë menaxhimi i pasurisë dhe menaxhimi i shpenzimeve nga mallrat dhe shërbimet.

### 4.2 Qeverisja e mirë

#### **Përshkrim**

ZKM është përgjegjëse për të gjitha aktivitetet financiare dhe menaxheriale të agjensioneve të saj vartëse: Agjensionit të Statistikave të Kosovës (ASK), Agjensioni Shtetëror të Arkivave të Kosovës (AShAK), Agjensioni të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), dhe Agjensionit për Barazi Gjinore (ABGj), të cilat e kanë strukturën e tyre organizative dhe prodhojnë PF-të e veta të cilat më pas konsolidohen në pasqyrat financiare të ZKM-së.

## Rekomandimet

---

### Çështja 3 - Proceset e llogaridhënies – Prioriteti i lartë

**E gjetura** Procesi i konsolidimit të PVF-ve në ZKM nuk ishte adekuat për shkak të aranzhimeve joefektive të llogaridhënies mes ZKM-së dhe agjencive të saj. Kryeshefat Ekzekutiv të Agjencive raportojnë tek Zëvendës Kryeministrat për fusha të caktuara të përgjegjësisë. Përderisa, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për cilësinë e PVF-ve të konsoliduara, ai nuk pranon raporte të rregullta nga Kryeshefët e agjencioneve dhe nuk është i informuar në lidhje me çështjet të cilat mund të kenë ndikim në konsolidimin e PVF-ve.

Raportimi i brendshëm mbi pasuritë dhe llogaritë e arkëtueshme nuk ishte i plotë dhe i saktë. Kjo ka ndodhur për shkak se ZKM nuk monitoron në mënyrë të drejtpërdrejtë ndryshimet në pasuri apo grumbullimin e të hyrave në agjensionet e saj vartëse. Në vend të kësaj, pasqyrat vjetore të agjencive konsolidohen në PVF e ZKM-së..

**Rreziku** Mungesa e drejtpërdrejtë e raportimit të agjencioneve tek Sekretari i përgjithshëm redukton efektivitetin e kontrollit buxhetor dhe procesin e përgatitjes së PVF-ve. Po ashtu zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë.

**Rekomandimi 3** ZKM duhet të siguroj që marrëveshjet e zgjeruara të llogaridhënies janë vendosur në mes të ZKM-së dhe agjencive të saj të cilat sigurojnë struktura efikase të raportimit për të mbështetur menaxhimin financiar në kohë dhe të fuqishëm nga ZKM mbi të gjitha fushat e përgjegjësisë dhe të mbështesë një proces efektiv të konsolidimit PVF.

#### **Çështja 4 - Mungesa e raporteve me shkrim të menaxherëve operativ - Prioriteti i lartë**

- E gjetura** Raportimi i menaxherëve operative në ZKM për shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë nuk ishte në nivelin e duhur. Sekretari i Përgjithshëm në ZKM mbante takime të rregullta javore, mirëpo vetëm ZKF përgatiste raporte javore të cilat nuk ofrojnë të dhëna të mjaftueshme financiare apo dëshmi për shqyrtim kritik. Këto raporte janë të përgjithësuara. Përderisa, raportime nga zyrtari çertifikues dhe ai i prokurimit nuk kishte.
- Rreziku** Cilësia e dobët e raportimit financiar tek menaxhmenti i lartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar në mënyrë aktive aktivitetet e ZKM-së, dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe të vonojë veprimet e nevojshme për ti adresuar ato.
- Rekomandimi 4** Sekretari i Përgjithshëm duhet të kryejë një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë. Kjo duhet të përfshijë raporte që i ofrojnë një nivel të përshtatshëm të të dhënave financiare dhe operationale që mbulon të gjitha përgjegjësitë ZKM. Takime të ekipit të menaxhimit duhet të regjistrohen për të demonstruar shqyrtim kritik.

## 4.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

### Përshkrimi

Në kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për ZKM-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>11,341,006</b>	<b>11,885,741</b>	<b>9,275,391</b>	<b>9,125,233</b>	<b>7,642,190</b>
Granti i Qeverisë - Buxheti	10,958,833	10,654,259	8,785,284	8,603,436	6,779,013
Të bartura nga viti paraprak <sup>3</sup> -	0	111,985	100,129	0	0
Të hyrat vetanake <sup>4</sup>	382,173	382,173	166,087	261,888	244,099
Donacionet e brendshme	0	19,547	0	218,695	231,420
Donacionet e jashtme	0	717,777	223,891	39,557	387,658

Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, është më i lartë për 544,735€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të jashtme dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak si dhe nga donacionet e brendshme prej 849,309€. Megjithatë granti i qeverisë është zvogëluar për 304,574€ pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2013, ZKM ka realizuar 78% përderisa në 2012 ky realizim ishte në nivel prej 82%. Ekzekutimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

<sup>2</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>3</sup> Të hyrat vetanake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Një pjesë e faturave të planifikuara dhe të mbledhura për Buxhetin e Kosovës në vitin aktual që është përdorur nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>11,341,006</b>	<b>11,885,740</b>	<b>9,275,596</b>	<b>9,125,233</b>	<b>7,642,190</b>
Pagat dhe Mëditjet	3,420,238	3,603,270	3,192,556	3,006,973	2,591,845
Mallrat dhe Shërbimet	2,753,970	4,509,910	3,360,023	2,955,591	2,543,889
Shërbimet komunale	234,798	205,798	119,895	135,011	115,215
Subvencionet dhe Transferet	1,280,000	1,389,181	1,173,989	1,211,450	951,811
Investimet Kapitale	3,652,000	2,177,580	1,428,925	1,816,207	1,439,429
Rezervat					

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Rritja e buxhetit për Paga dhe Mëditje me 183,032€ është si rezultat i rritjes së numrit të rekrutimeve në ZKM dhe në agjensionet vartëse të saj, themelimit të komisioneve të ndryshme pune dhe për stafin e përfshirë në “Fondin për Kuadro”. Suficiti domethënës kundrejt buxhetit në kategorinë paga dhe mëditje është për shkak të lëvizjeve të stafit për arsye të ndryshme si pushime të lehonisë, suspendime, apo lënies së punës.
- Buxheti për Mallra dhe Shërbime me rishikim është rritur për 1,420,064€ nga granti qeveritar, 111,985€ nga të hyrat e bartura nga viti i mëparshëm, dhe 223,891€ nga donatorët e jashtëm. Granti nga donatorët e jashtëm është shfrytëzuar për shërbime informative si *botimet e publikimeve, harduer për teknologji informative*, si dhe shërbime tjera kontraktuese. Suficiti domethënës kundrejt buxhetit në kategorinë mallra dhe shërbime sipas analizave tona ishte për shkak të parashikimit jo të mirë të nevojave të organizatës. Përkundër rritjes, niveli i obligimeve të papaguara në kategorinë mallra dhe shërbime ishte 128,677€;
- ZKM kishte pasur zvogëlim të buxhetit për investime kapitale në krahasim me vitin e kaluar për 14%. Kjo për arsye se vetëm 72% e buxhetit të vitit të kaluar i ndarë për këtë kategori ishte shpenzuar. Me rishikim të buxhetit 1mil € për “Ndërtimin e fabrikës për riciklimin e nën-produkteve shtazore” është ri-alokuar për vitin 2014 si rezultat i vonesave nga Zyra e Komisionit Evropian. Edhe në 2013 realizimi ka rezultuar më i dobët se vitin e kaluar, rreth 65%. Programi për Investime Publike përfshin disa projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe dy projekte të reja për vitin aktual. Projekti IPA “Kontrolla e sëmundjeve zoonotike” prej 90,000€ nuk kishte filluar në vitin 2013. Faktorët që kanë ndikuar në mos



realizim të kapitaleve sipas konfirmimeve të AUV-it ishin vonesa në nënshkrimin e kontratave, mos pranimit të punëve për shkak të parregullsive në terren, anulimi i procedurave të prokurimit në mungesë të operatorëve të përgjegjshëm.etj. Për më shume një projekt i buxhetuar tek kapitalet 30,000€ është realizuar nga mallrat dhe shërbimet në AUV.

- Buxheti për shërbimet komunale ishte reduktuar për 12,000€ në krahasim me vitin e kaluar. Realizimi në këtë kategori vazhdon të jetë i ulët (vetëm 58%) ngjashëm me vitin e kaluar ku realizimi ishte rreth 62%. Bazuar në nënshpenzimet e viteve të kaluara është e qartë që planifikimi i buxhetit në këtë kategori nuk është i mirë; dhe
- Buxheti për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve është realizuar rreth 85%. Pjesa me e madhe e buxhetit të kësaj kategorie i takon zyrës për komunitete. Qëllimi i dhënies së këtyre subvencioneve është kryesisht për të integruar sa me tepër komunitetet pakicë në Kosovë.

**Tabela 3. Të hyrat e inkasuara për buxhetin e Kosovës – realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Pranimet	2012 Pranimet	2011 Pranimet
Të hyrat	382,173	382,173	5,491,668	4,258,169	3,973,745
<b>Totali</b>	<b>382,173</b>	<b>382,173</b>	<b>5,491,668</b>	<b>4,258,169</b>	<b>3,973,745</b>

Totali i të hyrave të inkasuara reflekton vlerën prej 5,491,668€, prej tyre 382,173€ janë lejuar të shpenzohen për nevojat e AUV dhe AShAK. Pjesa e mbetur e të hyrave të inkasuara janë transferuar në Buxhetin e Kosovës. Trendi i të hyrave është në rritje nga viti 2011. Një rritje sinjifikante vërehet nga 2012 në 2013. Meqenëse nuk ka ndryshim të aktiviteteve në organizate, kjo rritje është sinjal se kontrollet janë forcuar dhe është rritur efikasiteti i ofrimit të shërbimeve në AUV.

---

## Rekomandimet

---

### Çështja 5 - Ekzekutimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

**E gjetura** Ekzekutimi i buxhetit në të gjitha kategoritë ekonomike ishte jo adekuat dhe pozicioni i përgjithshëm ishte më keq se në vitin 2012. Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve buxheti i pashpenzuar në mënyrë të konsiderueshme tejkalon detyrimet e papaguara. Përderisa ekzekutimi i vetëm 65% në kapitale dhe 58% në shërbimet komunale tregojnë që planifikimi në këto dy kategori nuk ishte i mirë.

**Rreziku** Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe ekzekutimi i ulët i buxhetit mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.

**Rekomandimi 5** Përgatitja e buxhetit paraprihet nga një proces rigoroz i vlerësimit që pasqyron të gjitha informatat relevante përfshirë realizimin në vitet e mëparshme / dhe ndryshimet e pritura të vitit. Performanca buxhetore duhet të monitorohet në baza mujore dhe pengesat për nivelet e planifikuara të ekzekutimit të buxhetit të identifikohen dhe adresohen me kohë.

### Çështja 6-Klasifikimi i buxhetit për mallra dhe shërbime si investime kapitale- Prioritet i lartë

**E gjetura** Në AUV transaksionet<sup>5</sup> prej 554,219€ janë klasifikuar si investime kapitale të cilat sipas rregullave të thesarit i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime. Me gjithë përpjekjet e ZKM-së për të ndryshuar buxhetin, kjo çështje nuk është adresuar nga Ministria e Financave (MF). Kjo situatë është shpalosur plotësisht në PVF.

**Rreziku** Keq klasifikimi i buxhetit/shpenzimeve për mallra dhe shërbime si investime kapitale redukton tansparencën dhe ndikon në kredibilitetin e Pasqyrave Financiare duke dërguar në nënlverësimin e mallrave dhe shërbimeve respektivisht mbivlerësimin e investimeve kapitale.

**Rekomandimi 6** Të shtohet komunikimi me MF për të siguruar që hartimi i buxhetit dhe klasifikimi i shpenzimeve të bëhet sipas planit kontabël të thesarit për të mundësuar regjistrimin dhe raportimin e duhur të shpenzimeve.

---

<sup>5</sup> Vaksinat për kafshë, analiza laboratorike, kompenzime të dëmeve, shërbime veterinare, kampanja informative për sëmundje të kafshëve dhe shërbime të therrjes dhe groposjes si dhe shërbime tjera në AUV

---

## 4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

### Përshkrimi

Të hyrat e gjeneruara nga ZKM në vitin 2013 ishin në total 5,491,668€. Këto të hyra kryesisht arkëtohen në AUV (rreth 96%) nga shërbimet e inspektimit të ushqimit dhe nga shërbimet tjera të veterinarisë. Pjesa tjetër e të hyrave vjen nga shitja e gazetës zyrtare dhe të hyrave nga qiraja.

### Rekomandimet

---

#### Çështja 7 - Mungesa e Softuerit - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Dobësitë ekzistojnë në regjistrimin e të hyrave. Kjo është për shkak se ZKM nuk posedon softuer për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave dhe të dhënat ekzistuese manuale nuk janë menaxhuar mirë. Kemi zbuluar raste ku i njëjti kod ekonomik është regjistruar për lloje të ndryshme të të hyrave dhe raportim të dobët financiar të të hyrave.

**Rreziku** Informacioni aktual mbi të hyrat mund të mos jetë i saktë ose i plotë dhe nuk është në dispozicion në kohën e duhur për të mbështetur marrjen e vendimeve të menaxhmentit. Sistemi manual ekzistues për sistemimin e informacionit mbi të hyrat mund të jenë subjekt i manipulimit apo mashtrimit.

**Rekomandimi 7** Kryeshefi në AUV duhet të sigurojë një zgjidhje të përshtatshme për softuer i cili zhvillohet dhe testohet brenda vitit aktual financiar me theks të vendosur në nivelin e duhur të funksionalitetit, në mënyrë që të plotësoj kërkesat e specifikuar të menaxhimit.

## **Çështja 8- Mungesë e rregullores për procedurat e ankandit të mishit -Prioriteti i lartë**

- E gjetura** AUV gjithsej kishte grumbulluar të hyra nga shitja e mishit nga gjedhet e konfiskuara prej 114,454€. Shitja ishte bërë me ankand publik mirëpo në të gjitha rastet (33 raste) ishte vetëm një ofertues i cili ishte edhe përfitues i kontratës. Për shkak të vonesave në shitje të mishit AUV kishte humbje në realizimin e të hyrave për arsye se mishi ishte i papërshtatshëm për shitje i cili njëherit ka shkaktuar kosto shtesë për asgjësimin e mishit. Kjo ka rezultuar nga mungesa e një rregulloreje për të përcaktuar mënyrën e shitjes dhe formave tjera të shmangies së humbjeve.
- Rreziku** Paraqitja e vetëm një ofertuesi në të gjitha rastet e ankandëve rritë rrezikun e shitjes së mishit me çmime më të ulta se çmimi i tregut. Po ashtu, mungesa e udhëzimeve dhe rregulloreve rrit rrezikun e humbjes financiare në rast të mos shitjes së mishit dhe kosto shtesë për asgjësimin e tij.
- Rekomandimi 8** Kryeshefi Ekzekutiv në AUV duhet të analizoj “tregun aktual të kafshëve” në Kosovë për të përcaktuar arsyet potenciale për mungesë të ofertuesve për shitje të mishit dhe të përdor këtë informacion për të kërkuar më shumë interes në ankand. Rregullat formale apo një udhëzim administrativ duhet të hartohet për të siguruar procedura në kohë dhe efikase për shitjen me ankand të mishit të konfiskuar.

## 4.5 Shpenzimet

### 4.5.1 Prokurimi

#### Përshkrimi

Procesi i prokurimit në ZKM zhvillohet në mënyrë të pavarur në të gjitha agjensionet ku secili agjension përgatit planin e prokurimit dhe zhvillon procedurat e prokurimit. Ne kemi testuar procedurat e prokurimit në secilin agjension dhe kemi vërejtur se në përgjithësi në ZKM kontrollet në fushën e prokurimit kanë funksionuar. Megjithatë janë disa aspekte të procesit të prokurimit mbi të cilat kontrollet nuk janë aplikuar në mënyrë efektive. Në vazhdim janë detajet e të gjeturave në këtë fushë.

#### Rekomandimet

---

#### Çështja 9 - - Dobësitë sistematike të procedimit të pagesave- Prioritet i lartë

<b>E gjetura</b>	<p>Ne kemi identifikuar se disa kontrolle menaxheriale nuk janë zbatuar me konsistencë dhe kanë rezultuar me:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Në nëntë raste faturat/obligimet ndaj furnitorëve ishin paguar pas afatit kohor ligjor prej 30 ditëve;</li><li>• Në 35 raste urdhër-blerja, kërkesa për blerje / zotimi i mjeteve në vlerë 424,683€ ishin bërë pas pranimit të mallrave dhe shërbimeve, përkatësisht pas pranimit të faturës;</li><li>• Në katër raste kërkesat për zotim të fondeve në vlerë prej 13,745€ nuk ishin autorizuar nga zyrtari autorizues.</li></ul>
<b>Rreziku</b>	<p>Hyrja në obligime pa zotim të mjeteve rrit rrezikun e mbetjes pa mjete duke rritur kështu numrin e obligimeve të papaguara në fund të vitit.</p>
<b>Rekomandimi 9</b>	<p>Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeshefat Ekzekutiv duhet të përcaktojnë se pse kërkesat specifike të procedimit të pagesave nuk janë adresuar në mënyrë të vazhdueshme dhe për të identifikuar në mënyrë të qartë barrierat për zbatimin efektiv të kontrolleve ekzistuese. Kontrollet e shtuara / rritur për shqyrtim mbikëqyrës duhet të zbatohen për të siguruar që gabime të ngjashme janë shmangur në të ardhmen ..</p>

### **Çështja 10-Dobësi jo sistematike në procesin e prokurimit - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Tek prokurimi për “Shërbimet e transportit, therjes dhe groposjes së kafshëve të diagnostifikuara me sëmundje”, operatori ekonomik fitues nuk ka sjellur tri nga dokumentet e kërkuara me rastin e nënshkrimit të kontratës siç janë: vërtetimi nga ATK për kryerjen e obligimeve, dëshminë për pagesën e energjisë elektrike, si dhe sigurinë e ekzekutimit.

Tek kontrata për furnizim me reagjent dhe material laboratorik për AUV-në e nënshkruar me datën 25.10.2011 në kohëzgjatje prej 24 muajsh, furnizimi prej 9,383€ ishte bërë një muaj pas skadimit të kontratës

**Rreziku** Mos siguri i dokumentacionit që vërteton aftësinë paguese të operatorit ekonomik mund të rezultojë në kontraktorë të cilët nuk janë në gjendje të përmbushin kërkesat e kontratës që rezultojnë në përfundimin e vonuar e kontratës dhe kostove shtesë..

Furnizime e pranuar pas skadimit të kontratës mund të rezultojë në çmime më të larta të paguara dhe dështimit për të arritur vlerën për para

**Rekomandimi 10** Kryeshefi në AUV duhet të rishikojë procedurat e prokurimit në rastet e identifikuara më lart për të përcaktuar se pse kërkesat specifike të prokurimit nuk janë adresuar dhe zbatuar kontrole të zgjeruara për të siguruar që gabime të ngjashme janë shmangur në të ardhmen.

## 4.5.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

### Përshkrim

Ne kemi testuar shpenzimet për udhëtime zyrtare, avanset dhe shpenzimet komunale. Testimet tona kanë vënë në pah që mbyllja e avanseve vazhdon të jetë sfidë për ZKM-në. Megjithatë, përmirësime të dukshme janë vënë re në raport me vitin e kaluar.

### Rekomandimet

---

#### Çështja 11- Mos-mbyllja e avanseve me kohë - Prioriteti i mesëm

**E gjetura** Sipas UA 2004/07, për udhëtime zyrtare dhe rregullës 01/2013, avanset për udhëtime zyrtare duhet të mbylljen dhe shumat e pa shpenzuara të kthehen në llogarinë bankare brenda dy javësh pas kthimit nga udhëtimi. Ne kemi vërejtur se avanset për udhëtime zyrtare nuk ishin mbyllur dhe arsyetuar brenda afatit kohor ligjorë në vlerë 17,775€.

**Rreziku** Kontrolllet jo efektive në mbylljen e avanseve për udhëtime zyrtare rrisin rrezikun e mos kthimit të mjeteve dhe shfrytëzimin e tyre për qëllime tjera prej atyre zyrtare.

**Rekomandimi 11** Sekretari i Përgjithshëm duhet të rishqyrtojë nevojën për aplikimin e rregullave ekzistuese lidhur me avanset dhe të sigurojë se arritja e afateve kohore të kërkuara monitorohet në mënyrë formale dhe raportohet tek menaxhmenti i lartë në periudhë tre mujore.

## 4.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

### Përshkrimi

Kontrollet që operojnë në ZKM kanë të bëjnë me autorizimin e payroll-it, një analizim i variancave dhe harmonizimeve të ndryshme.

Nga mostrat e testuara kemi konstatuar se dosjet e të punësuarve janë mbajtur dhe azhurnuar rregullisht nga zyra e personelit, varësisht prej ndryshimeve të ndodhura të stafit të punësuar.

Nga testimet e transaksioneve sipas listës së pagave kemi vërejtur se sektori i financave është njoftuar rregullisht dhe me kohë lidhur me ndryshimet në paga dhe mëditje. Të gjitha ndryshimet e ndodhura janë bërë me vendimet përkatëse.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

## 4.5.4 Subvencionet dhe Transferet

### Përshkrimi

ZKM gjatë vitit 2013, kishte dhënë subvencione në bazë të marrëveshjes me Komuna, marrëveshjeve individuale direkt me përfituesit dhe në bazë të vendimeve të Kryeministrit.. Pjesa më e madhe e subvencioneve është dhënë për entitetet jo publike. Përfitues të subvencioneve ishin edhe entitetet publike dhe përfituesit individual.

Buxheti për subvencione ishte i ndarë në pesë departamente ku pjesëmarrje më të madhe në shpenzim kishte Zyra për komunitete me 981,610€ dhe kabineti i Kryeministrit me 98,571€. Ne i kemi cekur mangësitë lidhur me mangësitë në subvencion në seksionin 2.2, megjithatë, çështjet tjera që poashtu kërkojnë vëmendjen e menaxhmentit janë të prezentuara më poshtë.

### Rekomandimet

---

#### Çështja 12 - Mungesa e politikës së shkruar dhe mungesa e raportimit për subvencionet e dhëna me marrëveshje- Prioritet i lartë

**E gjetura** ZKM nuk kishte ndonjë politikë të shkruar (strategji) me anë të së cilës do të përcaktohej se cilat janë objektivat e saj që do të arrihen lidhur me subvencionet. ZKM kishte dhënë subvencione mbi bazën e vendimeve të Kryeministrit, dhe marrëveshjeve individuale por nuk kishte kriteret të qarta përmes të cilave do të përzgjidhej përfituesi i subvencioneve.

Në gjashtë raste me vlerë 33,500€ nuk kishte raportime nga ana e përfituesit konform marrëveshjeve direkte me përfituesit . ZKM ka një formë standarde të raportimit dhe në rastet e cekura më lartë kjo formë nuk ishte plotësuar nga përfituesit. Ndërsa në pesë raste me vlerë prej 35,530€ mungonte argumentimi i shpenzimeve konform marrëveshjes.

**Rreziku** Mungesa e një politike (strategjie) për subvencionet respektivisht mungesa e kriterëve të qarta për dhënien e tyre si dhe mungesa e raportimeve rrisin rrezikun që paraja publike të mos shpenzohet për qëllimet e duhura.

**Rekomandimi 12** Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj hartimin e një politike në të cilën do të përcaktoheshin prioritetet për subvencione, si dhe do të definonte objektivat, kriteret dhe kërkesat për raportim.



## 4.6 Pasuritë dhe detyrimet

### 4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

#### Përshkrim

ZKM kishte pasuri neto të paraqitur në SIMFK në vlerë prej 3,236,998€. Kishte zvogëlim prej 49,563€ ne raport me vitin e kaluar, për shkak të numrit të vogël të investimeve kapitale dhe zhvlerësimit të lartë. Menaxhimi i pasurive në ZKM është kryer në mënyrën e duhur megjithatë mangësi domethënëse janë vërejtur në Agjencitë Ekzekutive.

#### Rekomandimet

---

#### Çështja 13 - Regjistri jo i plotë i pasurisë jo-kapitale në ASHAK dhe AUV- Prioriteti i mesëm

**E gjetura** Në ASHAK nuk ka zyrtar të pasurisë. ushtruesi i detyrës deklaroi se vlera e pasurisë nën 1,000€ ishte 81,688€, përderisa sipas raportit të zyrtares kryesore financiare të dërguar në ZKM vlera e pasurisë ishte 39,513€, një mospërputhje prej 42,175€.

Po ashtu, ASHAK kishte regjistruar vetëm pasuritë jo-kapitale ndërsa për pasuri kapitale ky agjencion nuk kishte të dhëna. Të dhënat për pasurit e tyre i mban ZKM. Disa pasuri jo kapitale në vlerë prej 5,985€ nuk ishin regjistruar në regjistrat e këtij Agjensioni.

Në AUV janë evidentuar 10 vetura të cilat ishin donacion nga EULEX-i të pa regjistruara në regjistrat e pasurisë së AUV-it.

**Rreziku** Mos kompletimi i regjistrit të pasurisë mund të rezultojë në gabime materiale në PVF. Megjithatë, gabimi aktual në pasuri nuk është material mirëpo nëse nuk merret parasysh në vitet e ardhshme mund të rezultojë në theksimin e çështjes.

**Rekomandimi 13** Kryeshefat Ekzekutiv të agjensioneve vartëse të ZKM-së duhet të sigurojnë që janë forcuar mekanizmat e kontrollit të cilat sigurojnë se regjistrat e pasurisë janë të azhurnuar me informata të sakta dhe të plota në secilin agjencion para konsolidimit në PVF, dhe se janë bërë kontrole adekuate lidhur me shifrat e raportuara.

#### **Çështja 14 - Mos regjistrimi dhe raportimi i ndërtesës dhe tokës ku operojnë AUV dhe ASK- Prioritet i lartë**

**E gjetura** Toka dhe ndërtesat në posedim të AUV-së dhe ASK-se nuk ishin regjistruar në regjistrat e tyre dhe si pasoj as nuk janë raportuar në PVF 2013. AUV kishte dokumentacionin përkatës që konfirmonte posedimin e tokës dhe ndërtesës ndërsa, në Agjensionin e Statistikave të Kosovës mungojnë dokumentet të cilat e dëshmojnë pronësinë e tokës dhe objektit në të cilin operon ky agjension. Si pasojë, pronat dhe ndërtesat nuk janë regjistruar në regjistra të thesarit pasi që procedura nuk e lejon regjistrimin pa dokumente të pronësisë.

**Rreziku** Mos regjistrimi i pronës në regjistrin e thesarit rrit rrezikun e nënvlerësimit të pasurisë së deklaruar në PVF-të e ZKM. Regjistrat jo të plotë të pasurisë mund po ashtu të rezultojnë në planifikim të dobët të buxhetit lidhur me mirëmbajtjen e nevojshme dhe shpenzimet tjera.

**Rekomandimi 14** Kryeshefat Ekzekutiv duhet të sigurojnë që janë ndërmarr masat konkrete për sigurimin e dokumentacionit përkatës për posedim të tokës dhe ndërtesës , krijimin e komisioneve vlerësuese për vlerësimin e pasurisë, regjistrimin e tyre si dhe raportimin në PVF.

#### **Çështja -15-Mungesa e evidencave të stoqeve të AUV-it- Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Në AUV nuk mbahen evidenca rreth pranimit, shpërndarjes dhe gjendjes në stoqe. AUV nuk kishte të caktuar zyrtarë të depos dhe nuk kishte deleguar këtë përgjegjësi tek ndonjë zyrtarë tjetër për menaxhimin e materialit shpenzues. Po ashtu AUV nuk e aplikon softwerin *e-pasuria*.

Pas rekomandimit tonë në memon e auditimit është angazhuar një zyrtar i depos, mirëpo ai ende nuk kishte arritur të gjenerojë raporte lidhur me gjendjen e stoqeve.

**Rreziku** Mungesa e evidencave për menaxhimin e stoqeve vështirëson planifikimin, menaxhimin, mbikëqyrjen dhe raportimin adekuat të materialit shpenzues . Kjo poashtu mund të rezultojë në numrim dhe vlerësimin jo të sakt të stoqeve.

**Rekomandimi 15** Kryeshefi në AUV të siguroj që aplikacioni *e-pasuria* është funksionalizuar dhe se mbahen evidenca të plota dhe të sakta për pranimin, shpërndarjen dhe gjendjen e stoqeve.

## 4.6.2 Menaxhimi i automjeteve zyrtare

### Përshkrim

Njësia e transportit ka bërë menaxhimin e automjeteve zyrtare konform udhëzimit administrativ UA 03/2008 për përdorimin e automjeteve qeveritare. Janë mbajtur të gjitha shënimet lidhur me shpenzimet e mirëmbajtjes, shpenzimet e derivateve, si dhe kilometrat e kaluara për të gjitha automjetet. Megjithatë ekzistojnë disa mangësi të cilat do ti shpalosim me poshtë.

### Rekomandimet

---

#### Çështja 16 -Mungesë e evidencave të plota lidhur me përdorimin e automjeteve-Prioritet i mesëm

**E gjetura** Në dosjet e katër automjeteve, kërkesa për udhëtim zyrtar dhe fletudhëtimet nuk ishin plotësuar rregullisht siç kërkohet me UA 03/2008 për menaxhimin e automjeteve qeveritare.

**Rreziku** Mos kontrollimi i përdorimit të automjeteve mund të rezultojë në përdorimin e tyre për qëllime jo zyrtare dhe shpenzime shtesë për ZKM-në.

**Rekomandimi 16** Sekretari i Përgjithshëm të forcojë kontrollet sa i përket përdorimit të automjeteve në mënyrë që të sigurojë se automjetet përdoren vetëm për qëllime zyrtare në përputhje me UA 03/2008.

## 4.6.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve

### Përshkrim

Llogaritë e arkëtueshme pasqyrojnë obligimet e klientëve ndaj ZKM-së për shërbimet e ofruara nga kjo e fundit. Meqenëse, pagesat për gazetën zyrtare bëhen në mënyrë automatike përmes bankave komerciale, ky lloj i të hyrave nuk lejon krijimin e llogarive të arkëtueshme. Ndërsa në AUV ekziston një vlerë prej 9,015€ e llogarive të arkëtueshme të cilat nuk janë evidentuar në PVF 2013.

---

## Rekomandimet

---

### Çështja 17 - Llogarit e arkëtueshme nuk janë shpalosur në PVF -Prioritet i mesëm

**E gjetura** Në PVF nuk janë përfshirë faturat në vlerë prej 9,015€ për shërbimet e ofruara nga AUV por të cilat nuk janë paguar.

**Rreziku** Mos deklarimi i llogarive të arkëtueshme në PVF ka bërë që të nënvlerësohen të hyrat e ZKM-së.

**Rekomandimi 17** Kryeshefi në AUV duhet të siguroj që janë të evidentuara të gjitha llogaritë e arkëtueshme dhe janë të pasqyruara në shënimet shpjeguese të PVF të cilat i dërgohen ZKM-së për konsolidim.

## 4.6.4 Trajtimi i borxheve

### Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2013 ishte 353,322€. Nga kjo vlerë e obligimeve 217,629€ i takonin investimeve kapitale, 128,677€ për mallra dhe shërbime dhe 7,015€ për shërbime komunale.

## Rekomandimet

---

### Çështja 18 -Obligimet e papaguara- Prioritet i lartë

**E gjetura** Vlera e obligimeve të papaguara reflekton një rritje të dukshme në krahasim me vitin 2012 ku borxhet ishin në vlerë prej 104,800€. Disa nga obligimet e 2013 u takojnë muajve të fillimit të vitit 2013. Në arsyet e dhëna në shpalosjet e obligimeve në shumicën e rasteve ishte mbyllja e zotimeve. Kjo dhe të gjeturat e shpalosura në nënkapitullin 4.5.1 Prokurimi konfirmon që ZKM ka hyrë në obligime pa zotimin e mjeteve.

**Rreziku** Rritja e obligimeve të papaguara jo vetëm që paraqet menaxhim jo efikas të parasë publike për vitin fiskal por njëkohësisht ndikon në buxhetin e vitit vijues. Po ashtu, hyrja në obligime pa zotimin e mjeteve mund të rezultoj në pamundësinë e pagesës së tyre.

**Rekomandimi 18** Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeshefat Ekzekutiv të marrin masat e duhura për të siguruar se kryejnë me kohë të gjitha obligimet, dhe nuk hyn në obligime pa zotimin e mjeteve.

## 4.7 Sistemi i auditimit të brendshëm

### Përshkrimi

NJAB përbëhet vetëm nga një auditor i cili është edhe Drejtor i NjAB-së. Gjatë vitit 2013 ishin të planifikuara gjithsej katër auditime ndërsa ishin finalizuar tre nga të cilat njëri kishte mbuluar aktivitetet e vitit paraprak. NJAB kishte të aprovuar planin strategjik i cili ishte në harmoni me planin vjetor dhe ZKM kishte të themeluar Komitetin e Auditimit i cili kishte mbajtur katër takime.

NjAB, përmes raporteve të auditimit, i kishte ofruar menaxhmentit informata dhe vlerësime të dobishme nëse kontrollet e vendosura janë efektive.

### Rekomandimet

---

#### Çështja 19 - Mos realizimi i planit të auditimit të brendshëm - Prioritet i lartë

**E gjetura** Aktivitetet e ZKM-se janë të gjera dhe komplekse, një auditor nuk mund të krijojë një plan të bazuar në rrezik dhe t'i mbulojë të gjitha aktivitetet domethënëse.

**Rreziku** Mungesa e një plani të qartë të auditimit do të rezultojë që menaxhmenti të mos marrë nivelin e duhur të sigurisë nga AB lidhur me efektivitetin e kontrolleve të brendshme në të gjitha fushat e rëndësishme të aktiviteteve në mënyrë periodike. Dobësitë nuk mund të identifikohen dhe ZKM mund të pësojë humbje financiare, vlerë të dobët për parane dhe jo efektivitet në kryerjen e aktiviteteve operative.

**Rekomandimi 19** Kryeministri duhet të sigurojë staf të mjaftueshëm për të siguruar NjAB efektiv dhe të sigurojë se aktivitetet në të ardhmen bazohen në rrezik duke ofruar mbulueshmëri të të gjitha fushave të rëndësishme çdo vit.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;

Të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.



## Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2. Pasqyrat Financiare	Sekretari i Përgjithshëm, duhet të siguroj se shënimet shpjeguese të PVF-ve shpalosen në pajtim me formatin dhe mënyrën e përcaktuar ligjore, në mënyrë që informatat të jenë sa më të qarta.		PVF-të janë korrigjuar në lidhje me shpalosjen e obligimeve të papaguara, subvencionet dhe transferet dhe detyrimet kontigjente, mirëpo nuk janë shpalosur llogarite e arkëtueshme.	
3. Rekomandimet e vitit paraprak	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se plani i veprimit është rishikuar dhe përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar - dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësisë më kyqe.	Është adresuar plotësisht		
4. Realizimi i buxhetit	Sekretarit i Përgjithshëm duhet ti vlerësojë përgjatë gjithë vitit arsyet për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit dhe ti përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e nivelit të ekzekutimit.			Nuk janë marrë masa

4.4 Te hyrat	Sekretari i përgjithshëm përmes kryeshefit ekzekutiv të ASHAK-ut duhet të siguroj evidenca financiare të plota dhe të sakta për klientët.	Është adresuar		
4.5 Shpenzimet	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj: 1. Se aktivitetet e prokurimit zhvillohen konform kërkesave të LPP-së		Është bërë progres i dukshëm, por ka ende mangësi në AUV	
	2. Se është duke aplikuar procesin e mbikëqyrjes së kontratave	Është adresuar		
	3. Kontrollle adekuate për të parandaluar regjistrimin e shpenzimeve në kategori dhe kode të gabuara.			Nuk janë marrë masa
	4. Zotimin e fondeve buxhetore, në mënyrë që projektet e planifikuara të mund të realizohen në linjë me objektivat e synuara.			Nuk janë marrë masa
	5. Ti identifikojë shkaktarët për vonesat në kryerjen e pagesave dhe marrjen e veprimeve për tu siguruar që ato përfundohen brenda afateve kohore të pritshme.			Nuk janë marrë masa
Shpenzimet tjera	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se, kontrollet që kanë të bëjnë me avanset duhet të shqyrtohen dhe të ngritet niveli i tyre për të siguruar arsyetime të qëndrueshme dhe kthimin e fondeve në kohën e duhur.			Nuk janë marrë masa

4.6 Subvencionet dhe Transferet	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se janë shqyrtuar kontrollet ekzistuese për sa i përket subvencioneve dhe të konsideroj marrjen e veprimeve shtesë për të siguruar arritjen e qëllimeve të dakorduara me marrëveshje.			Nuk janë marrë masa
Pasuritë	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se regjistrat e pasurisë janë përditësuar me informata të sakta dhe të plota, duke u klasifikuar në kategoritë përkatëse.			Nuk janë marrë masa
Borxhet	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se janë identifikuar qartë shkaktarët që kanë rezultuar me detyrime të papaguara dhe të marrë masat e duhura për parandalimin e tyre.			Nuk janë marrë masa
Auditimi i brendshëm	Sekretari i Përgjithshëm duhet të konsideroj se NjAB është plotësuar me staf shtesë. Alternativë tjetër, mund të jetë themelimi i NjAB-ve në agjencionet (AUV dhe ASK) që karakterizohen me fushëveprim, organizim dhe madhësi buxhetore më të lartë.			Nuk janë marrë masa